



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.26

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9497 datë 20.3.2006	Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve..	869
Vendim i KM nr.159, datë 21.3.2006	Për mbylljen e Njesisë së Menaxhimit të Projektit për sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe transferimin e funksioneve të saj Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.....	871
Vendim i KM nr.160, datë 21.3.2006	Për rritjen e shtesës mbi pension për invalidët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.....	872
Udhëzim i MPPTT nr.2193, datë 28.3.2006	Për pajisjen me targa dhe leje qarkullimi të automjeteve të trupit diplomatik të huaj.....	872
Vendim i GJK nr.6, datë 31.3.2006	Me objekt konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	873
Vendim i KKRT nr.423, datë 21.3.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik vendor “OXYGEN”.....	878
Vendim i KKRT nr.424, datë 21.3.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “DEUTSCHE WELLE”.....	878
Vendim i KKRT nr.425, datë 21.3.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV SOT 7”.....	879
Vendim i KKRT nr.427, datë 21.3.2006	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “PËRMETI”...	879

Vendim i KKRT nr.428, datë 21.3.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TEPELENA SAT”.....	880
Vendim i KKRT nr.429, datë 21.3.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “BLU”.....	880
Vendim i KKRT nr.430, datë 21.3.2006	Mbi pavlefshmërinë e licencës së radios “FANTASY”.....	881
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetases Mirela Nasi.....	881

L I G J
Nr.9497, datë 20.3.2006

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Objekt i këtij ligji është krijimi i Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve, përcaktimi i fushës së veprimtarisë dhe i parimeve e rregullave të përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e kësaj Agjencie.

2. Funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve përcaktohen në statut, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Neni 2

Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (ASHBI), që më poshtë në ligj do të quhet thjesht "Alb-Invest", është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me seli në Tiranë dhe e ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Objekte të veprimtarisë së Alb-Invest-it janë:

- a) zbatimi i politikave dhe strategjive, zhvillimi i programeve dhe projekteve, në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat;
- b) studimi, kërkimi, analizat dhe konkluzionet për klimën e biznesit;
- c) nxitja, tërheqja dhe mbështetja e investimeve të huaja, në përputhje me përparësitë e politikës së Qeverisë;
- ç) identifikimi i mundësive për investime në Shqipëri dhe promovimi i tyre;
- d) nxitja e prodhimit vendas dhe e produkteve për eksport për në tregjet e huaja;
- dh) nxitja dhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- e) zhvillimi i veprimtarive të promocionit, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë;
- ë) dhënia e asistencës për lehtësimin e investimeve, vendase dhe të huaja, për shoqëritë eksportuese dhe sigurimi i të dhënave dhe i shërbimeve mbështetëse për investitorët dhe eksportuesit;
- f) bashkëpunimi me institucionet publike, financiare, organizatat e biznesit, të vendit dhe të huaja, për identifikimin e barrierave të zhvillimit të biznesit;
- g) botimi i të dhënave zyrtare për investimet, eksportet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- gj) dhënia e ekspertizës organeve të pushtetit qendror, vendor dhe investitorëve të huaj për fizibilitetin e investimeve.

Neni 4

Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të bashkëpunojnë me Alb-Invest-

in, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë, për përmbushjen e qëllimeve dhe të funksioneve të veprimtarisë së tij.

Neni 5

1. Alb-Invest-i, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të realizojë të ardhura nëpërmjet shërbimeve që kryen, në funksion të qëllimit dhe fushës së veprimtarisë së vet.

2. Alb-Invest-i nuk lejohet të ushtrojë veprimtari fitimprurëse.

3. Alb-Invest-i përgjigjet me mjetet e veta për detyrimet ndaj të tretëve.

KREU II ORGANET DREJTUESE TË ALB-INVEST-IT

Neni 6

Organet drejtuese të Alb-Invest-it janë:

a) Këshilli Drejtues;

b) Drejtori Ekzekutiv.

2. Këshilli Drejtues ka për detyrë të përcaktojë strategjinë, fushat dhe programin e veprimtarive të Alb-Invest-it, të shqyrtojë dhe të miratojë aktet më të rëndësishme për administrimin, organizimin, çështjet financiare dhe buxhetin e tij, mbikëqyrjen dhe kontrollin në vazhdimësi të realizimit të tyre, si dhe të vendosë për çështje të tjera, të parashikuara në ligj ose në statut.

3. Përbërja e Këshillit Drejtues të Alb-Invest-it, mënyra dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të tij caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Drejtimi i veprimtarisë së përditshme dhe përfaqësimi i Alb-Invest-it në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të statutit të tij, bëhen nga Drejtori Ekzekutiv.

2. Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

KREU III FINANCAT E ALB-INVEST-IT

Neni 8

Burimet e financimit të Alb-Invest-it janë:

a) Buxheti i Shtetit, në përputhje me situatën financiare;

b) donatorë të ndryshëm;

c) të ardhurat nga shërbimet dhe projektet e realizuara nga vetë ai.

2. Llogaritë e Alb-Invest-it kontrollohen nga ekspertë kontabël të autorizuar.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, fjalët “Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme” zëvendësohen me fjalët “Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve”.

Neni 10

Ligji nr.8877, datë 4.4.2002 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja”, ligji nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve”, si dhe nenet 12 e 13 të ligjit

nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, shfuqizohen.

Neni 11

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe për rregullimin e marrëdhënieve të parashikuara në nenet 1, 6 e 8 të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4825, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**VENDIM
Nr.159, datë 21.3.2006**

PËR MBYLLJEN E NJËSISË SË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT PËR SISTEMIN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE TRANSFERIMIN E FUNKSIONEVE TË SAJ ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Njesisë së Menaxhimit të Projektit (NMP) për sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si projekt dhe si njësi ekonomike e pavarur, në administrimin të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Arkivi dhe të gjitha funksionet, që lidhen me regjistrimin e pasurive të paluajtshme, t’i transferohen Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP).

3. Dorëzimi nga Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe marrja në dorëzim e pasurisë nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëhet sipas bilancit kontabël të datës 31.12.2005, duke zbritur:

- inventarin jashtë përdorimit, i cili përcaktohet nga një komision i përbashkët i Njesisë së Menaxhimit të Projektit dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- inventarin, i cili përdoret nga Instituti i Studimit të Tokave, Tiranë;
- debi-kreditë (detyrimet debitore dhe kreditore), të cilat i kalojnë për kontabilizim e ndjekje Institutit të Studimit të Tokave, Tiranë.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimet nr.81, datë 26.2.1993, nr.505, datë 26.10.1993, nr.149, datë 5.4.1994, nr.229, datë 4.7.1994, nr.174, datë 18.4.1995 dhe nr.432, datë 14.8.1995 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.160, datë 21.3.2006**

**PËR RRITJEN E SHITESËS MBI PENSION PËR INVALIDËT E LUFTËS KUNDËR
PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin

e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar” dhe të nenit 3 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtesa mujore, e përfituar sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të rritet në masën 20 për qind.
 2. Efektet financiare, në shumën 12 300 000 (dymbëdhjetë milionë e treqind mijë) lekë, për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.
 3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.3.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.2193, datë 28.3.2006

PËR PAJISJEN ME TARGA DHE LEJE QARKULLIMI TË AUTOMJETEVE TË TRUPIT
DIPLOMATIK TË HUAJ

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe pikës 2 të nenit 129 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,

UDHËZON:

1. Targat e veçanta të njohjes dhe lejet e qarkullimit për automjetet e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Tiranë, sipas kërkesës zyrtare të Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
2. Kërkesa e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme duhet të përmbajë:
 - tipin e automjetit,
 - numrin e shasisë,
 - ngjyrën e mjetit,
 - emrin e pronarit.
 - llojin e targës me të cilën do të pajiset mjeti.
3. Kërkesës së Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme duhet t’i bashkëlidhen (fotokopje):
 - vërtetim zhdoganimi;
 - faturë zhdoganimi;
 - dokumenti i hyrjes së automjetit, lëshuar nga organet përkatëse kufitare;
 - dokumenti me të dhënat teknike të mjetit;
 - fotokopje të kartës së identitetit, në rastin kur mjeti është për përdorim personal.
4. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Tiranë, sektori përkatës, bën kontrollin fizik të mjetit dhe lëshon “Certifikatën e kontrollit fizik”.
5. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Tiranë, sektori i regjistrimit, pas verifikimit të dokumenteve, bën regjistrimin e mjetit dhe lëshon targat dhe lejen e qarkullimit, sipas kërkesës së Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
6. Për gjithë praktikën e zbatuar për targat e veçanta të njohjes dhe lejet e qarkullimit, për automjetet e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Tiranë, mban arkiv të veçantë.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Tiranë, për targat e veçanta të njohjes dhe lejet e qarkullimit, të lëshuara për automjetet e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, njofton zyrtarisht Protokollin e Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

8. Targat për automjetet e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në kërkesën zyrtare të Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme sipas Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë, do të jenë të ndara si më poshtë:

- Targa me shkronjat TD me ngjyrë jeshile;
- Targa me shkronjat TK me ngjyrë jeshile;
- Targa me shkronjat TR me ngjyrë jeshile.

9. Udhëzimi nr.1927, datë 15.6.2000 “Për pajisjen me targa të mjeteve të trupit diplomatik” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
LULZIM BASHA

VENDIM
Nr.6 datë 31.3.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 29.9.2005 dhe 5.10.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.39/3 Akti që i përket:

KËRKUES: ENVER MEMISHAJ, përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. BASHKIA TIRANË, përfaqësuar nga juristja Natasha Kondi, me autorizim.

2. ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË, përfaqësuar nga përmbaruesi gjyqësor Anastas Kote, me autorizim.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 132/1, 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë nenet 6 e 41 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e 28 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Kërkuesi ka parashtruar se si shkak i mospërmblidhjes së rregullt të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, i është mohuar e drejta për të punuar në administratën publike në kushtet e parashikuara nga ligji, si dhe e drejta për t’u dëmshpërblyer për dëmet e shkaktuara nga vendime arbitrare të përfaqësuesve të pushtetit shtetëror në ushtrimin e kompetencave si punëdhënës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi është larguar nga puna me vendimin nr.844, datë 10.12.2001 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Mbi ankimin e tij, Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr.24, datë 6.2.2002, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit, anulimin e vendimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për largimin e tij nga puna dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Me kërkesë të tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.599, datë 4.6.2003, ka plotësuar vendimin e lartpërmendur, duke urdhëruar që kërkuesit t'i paguhet paga e plotë nga data 10.12.2001 deri në datën e zbatimit të vendimit të kthimit të tij në punën e mëparshme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjithashtu, me vendimin nr.599, datë 4.6.2003, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr.24, datë 6.2.2002 të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Zyra e Përmbartimit Tiranë nuk ka zbatuar vendimin e lartpërmendur dhe është shprehur që konflikti të zgjidhet sipas vendimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, i cili ka urdhëruar që kërkuesi të kalojë në listë pritjeje për punë.

Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj të datës 7.7.2004, ka detyruar përsëri Zyrën e Përmbartimit Tiranë që të zbatojë vendimin e formës së prerë, por dhe ky vendim nuk është zbatuar.

Bazuar në rrethanat e lartpërmendura, kërkuesi ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sepse organet përkatëse që detyrohen për ta zbatuar vendimin, nuk e kanë përmbushur këtë detyrim brenda një afati të arsyeshëm.

Para së gjithash, Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme për të analizuar se është kompetente për të shqyrtuar një kërkesë të tillë, konform nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos dhe për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Kjo kompetencë e Gjykatës Kushtetuese, gjithashtu, është e lidhur ngushtë me nenin 42 të Kushtetutës, që ka sanksionuar se:

1. *"Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor;*

2. *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj".*

Për natyrën dhe objektin që ka për çështjen në shqyrtim, interes të veçantë paraqet përmbajtja e nenit 142/3 të Kushtetutës, sipas të cilit organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.¹ Ky detyrim është konkretizuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nga del se vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatat dhe për institucionet e tjera.

Këto dispozita kushtetuese, lidhur me procesin e rregullt ligjor, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, janë trajtuar të lidhura ngushtë me paragrafin e parë të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku përcaktohet se: *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet detyrimisht dhe publikisht, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e krijuar ligjërisht, e cila vendos qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij".*²

Këto parime të rëndësishme të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të Konventës Europiane, të vështruara në kuadrin e të drejtave të njeriut, nënvizojnë edhe faktin se çdo qytetar që i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj, prandaj janë të lidhura me domosdoshmërinë e respektimit të një afati të arsyeshëm. Për shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit, kjo lidhje çmohet si e domosdoshme.

Për rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese hetoi dhe konstatoi se ndodhemi përpara refuzimit për ekzekutimin e vendimit nr.24, datë 6.2.2002 të Komisionit të Shërbimit Civil, që ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit për anulimin e vendimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, datë 10.2.2001 për largimin

¹ Neni 142/3 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

² Shih nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

nga Shërbimi Civil dhe kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.599, datë 4.6.2003, sipas të cilit kërkuesit t'i paguhet paga e plotë nga data 10.12.2001 deri në ditën e zbatimit të vendimit të kthimit të tij në vendin e mëparshëm të punës. Edhe ky vendim ka marrë formë të prerë.

Po ashtu, ka konstatuar se mosekzekutimi i vendimit ka ardhur për shkaqe subjektive, pasi Bashkia e Tiranës dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore që kanë për vënien në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, pasi nuk e kanë kthyer kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës dhe nuk e kanë paguar plotësisht për pagën sipas urdhërimeve të vendimeve të lartpërmendura.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjykimi për realizimin e një të drejte, si një proces kompleks, në vetvete përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën.

Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e të drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë.

Vendimi përfundimtar që i jep fund gjykimit në mënyrën e zakonshme, është akti që jep gjykata në përfundim të seancës, duke gjykuar çështjen në themel, me anë të të cilit pranon ose rrëzon padinë e paditësit. Në rastin kur gjykata pranon padinë e paditësit ajo konstaton se ekziston një dispozitë ligjore që i siguron një të drejtë palës paditëse ndërsa kur gjykata rrëzon një padi, ajo pranon se ligji i siguron anës së paditur një të drejtë të saj. Me fjalë të tjera, vendimi përfundimtar është akti që merr gjykata në përfundim të gjykimit të një çështje, me anë të të cilit pranon ose rrëzon padinë e paditësit. Ai bazohet vetëm në ligj dhe në provat e administruara gjatë gjykimit, të vlerësuara sipas bindjes së brendshme të gjykatës.

Organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore, të cilat janë të detyrueshme jo vetëm për palët, por dhe për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.

Sipas nenit 146 të Kushtetutës: “Gjykatat i japin vendimet *“Në emër të Republikës”*”. Ky deklaram kushtetues dëshmon faktin se vendimet e gjykatave janë vlerësuar nga Kushtetuta, si përsa i përket karakterit të tyre, ashtu dhe për pasojat që ato sjellin për shtetasit dhe për shoqërinë në tërësi.

I gjithë procesi gjyqësor, shpeshherë i vështirë e problematik, nuk do të kishte vlerë në qoftë se nuk do të pasohej nga një proces që lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e organeve të përmbartimit, me ekzekutimin e vendimit ose të realizimit të së drejtës së fituar.

Faza e dytë, kur lipset dhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese për zbatimin e tij, realizohet ajo që quajmë qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurtë, por kërkohet që ajo të vihet në jetë qoftë dhe me masa shtrënguese, nëse zbatimi vullnetar nuk jep rezultatet e duhura.

Duke qenë kështu, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë.

Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Por kjo çështje paraqet veçoritë e veta në një aspekt tjetër, sepse në këtë rast kjo gjykatë vetëm se konstaton shkeljen e bërë nga organet përkatëse, të cilat nuk kanë zbatuar pa shkaqe të përligjura ligjore një vendim të formës së prerë të gjykatës.

Është e vërtetë se natyra e vendimit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 132 të Kushtetutës, si rregull, lidhet me të drejtën për të shfuqizuar aktet që shqyrton.

Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese, duke pasur edhe shumë kompetenca të tjera veç atyre të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, është e detyruar të japë dhe vendime të llojeve të tjera, të ndryshme, pra dhe vendime konstatuese apo deklarative që në të vërtetë kanë efekte, pavarësisht se nuk janë të natyrës që shfuqizojnë një akt konkret. Kështu p.sh. Gjykata Kushtetuese vendos dhe për vërtetimin e pamundësisë së Presidentit të Republikës për të ushtruar funksionet e tij ose për zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të tij dhe të deputetëve, si dhe verifikimin e zgjedhjes së tyre. Në raste të kësaj natyre dhe për të tjera si këto, Gjykata Kushtetuese merr vendime që kanë një natyrë tjetër nga ato për të cilat bëhet fjalë në nenin 132 të Kushtetutës.

Pra, Gjykata Kushtetuese vendos nëse konstaton prekjën e një të drejte themelore nga organet që merren me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pas kësaj, çdo organ që ka detyrime nga vendimi përkatës, detyrohet të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin në mënyrë të plotë e të përpiktë me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Është fakt se individit që i drejtohet një gjykatë kompetente për realizimin e një të drejte nuk mund të presë pa kufi për ta realizuar atë, prandaj për këtë qëllim, Konventa Europiane ka insistuar në

përcaktimin e një afati, që sipas saj duhet të konsiderohet si afat i arsyeshëm.

Nisur nga ky detyrim, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka krijuar një praktikë të konsoliduar, si për shumë fusha të tjera, edhe për këtë problem konkret. Sipas saj, të gjitha shtetet detyrohen të organizojnë sistemin juridik në mënyrë të tillë që gjykatat të mundësojnë shqyrtimin e të gjitha çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, sepse “sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa që çojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në to”.³

Në lidhje me këtë çështje, jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ka krijuar tashmë një praktikë të pasur në interpretimin e përmbajtjes së nenit 6(1) të Konventës. Për këtë problem, ajo është shprehur se “në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai”,⁴ apo “faza ekzekutive duhet të llogaritet, pra të konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.”⁵

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke kritikuar rastet e interpretimit të ngushtë të nenit 6 të Konventës nga gjykata të vendeve të ndryshme, ka pohuar se: “në shoqërinë demokratike, në kuptimin e Konventës, e drejta për një proces të rregullt ... zë një vend të rëndësishëm, saqë çfardo interpretim i ngushtë i nenit 6(1) nuk do t’i përgjigjej as qëllimit dhe as karakterit të këtij neni”.⁶

Në mënyrë më të veçantë, është për t’u nënvizuar qëndrimi i kësaj Gjykate në çështjen “*Qufaj kundër Shqipërisë*”, ku Gjykata e Strasburgut vëren se “sistemi ligjor shqiptar ofron një rregullim në formë të një kërkesë ankese lidhur me dhunimin e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor”.

Më poshtë ajo thekson se: “dispozitat mbi procesin e rregullt gjyqësor në Shqipëri duhej të ishin interpretuar në mënyrë të tillë që të garantonin një mjet ankimor efektiv për shkeljen e pretenduar të nenit 6(1) të Konventës, prandaj Gjykata dha opinionin se Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën e shoqërisë në lidhje me mosrespektimin e një vendimi përfundimtar, si pjesë e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor”.⁷

Duke trajtuar këtë problem në lidhje me thelbin e saj e me interpretimin e nenit 6, Gjykata e Strasburgut në vendimin e saj, datë 19.3.1997 ka pohuar se: “Do të ishte e papërfytyrueshme që neni 6(1) të përshkruajë me hollësi garancitë procedurale që u jepen palëve ndërgjyqësore, pa siguruar mbrojtjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore pra neni 6 i saj ka të bëjë vetëm me të drejtën për t’iu drejtuar një gjykate. Kjo ka gjasa të çojë në situata të papajtueshme me parimin e sundimit të së drejtës, parim të cilin shtetet kontraktuese kanë marrë përsipër ta respektojnë kur ratifikuan Konventën. Në këtë mënyrë, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të dhëna nga çdo gjykatë duhet të shikohet si pjesë e pandarë e gjyqimit për qëllimet e nenit”.⁸

Edhe Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka bërë një rekomandim mbi ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore, të miratuar më 9 shtator 2003, ku ndër të tjera, rekomandon shtetet anëtare të Këshillit të Europës që të sigurojnë një autoritet administrativ që të zbatojnë vendimet gjyqësore brenda një kohe të arsyeshme “Në mënyrë që t’u jepet efekt i plotë këtyre vendimeve, ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme në përputhje me ligjin. Në të, rekomandohet, gjithashtu, se në rastet e moszbatimit të një vendimi gjyqësor nga një autoritet administrativ, duhet të parashikohet një procedurë e përshtatshme për të mundësuar ekzekutimin e tij, veçanërisht përmes një urdhërimit gjyqësor apo një gjobe detyruese. Është e rëndësishme të theksohet fakti se në këtë dokument rekomandohet që vendimet gjyqësore të gjejnë zbatim domosdo nga funksionarë publikë që janë të ngarkuar me këtë detyrë. Në rast se ata nuk përmbushin si duhet detyrat e tyre ligjore, mund të ngarkohen me përgjegjësi individuale ligjore sipas këtij rekomandimi.

Sa më lart, ankimi në Gjykatën Kushtetuese në raste të tilla konsiderohet si një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit “çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv para një instance kombëtare edhe atëherë kur kjo shkelje mund të jetë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”.

Ky qëndrim duhet parë lidhur edhe me parimin e sigurisë juridike, që kërkon që vendimet

³ Çështja “Bageta kundër Italisë”, vendim i datës 25.6.1998 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

⁴ Çështja “Giralanci kundër Italisë”, vendim i datës 19.2.1999 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

⁵ Çështja “Vakaturu kundër Italisë”, vendim i datës 25.5.1991 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

⁶ Çështja “Deleourt kundër Belgjikës”, vendim i datës 18.9.1998 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

⁷ Çështja “Qufaj kundër Shqipërisë”, vendim i datës 18.9.2004 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

⁸ Çështja “Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar”, vendim i datës 21.02.1975 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

gjyqësore të formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim për t'u zbatuar.⁹ Edhe Gjykata Kushtetuese, ka krijuar një praktikë të sajën duke u shprehur se “Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë” dhe se “asnjë organ shtetëror nuk mund të verë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.¹⁰

Meqenëse baza ligjore mbi të cilën ngrihet një kërkesë e tillë ka të bëjë drejtpërsëdrejti dhe me konceptin e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, është e nevojshme të sqarohet pozicioni i saj në të drejtën e brendshme shqiptare. Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore, përfshirë këtu dhe gjykatat e çdo niveli, si dhe organet që zbatojnë vendimet e tyre. Garancitë e Konventës ndikojnë në interpretimin dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të individit të shprehura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Veç kësaj, Gjykata Kushtetuese çmon se teksti i Konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese. Ky pozicion i Konventës, vjen si pasojë e angazhimeve të shtetit shqiptar për t'i dhënë një mbrojtje të garantuar të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Aspekt tjetër me rëndësi ka të bëjë me detyrimet që rrjedhin nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, për palët që marrin pjesë në gjykim, sepse sipas nenit 41 të Konventës, palët kontraktuese, me ratifikimin e Konventës, janë të detyruara të garantojnë përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me Konventën. Veç kësaj, praktika e kësaj Gjykate paraqet rëndësi për vlerat orientuese të jurisprudencës të saj edhe për gjykatat shqiptare.

Pra, ky problem ka mbetur për t'u vlerësuar rast pas rasti nga gjykatat që gjykojnë në shkallë të parë dhe nga ato që gjykojnë në shkallë të dytë, pa harruar se objekt i këtij vlerësimi, sipas Gjykatës së Strasburgut, duhet të jetë tërësia e procesit, së bashku me fazën e hetimeve dhe me shkallën e apelit, me procesin eventual para Gjykatës Kushtetuese, si dhe me ekzekutimin e vendimit.¹¹

Përsa u përket, duke u bazuar në këto standarde kushtetuese, kërkesa e kërkuarit, me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, duhet pranuar edhe për një shkak tjetër, sepse moszbatimi i një vendimi të tillë cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 131 shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit Enver Memishaj për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia Tiranë dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.423, datë 21.3.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR “OXYGEN”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të

⁹ Çështja Brumaresku kundër Rumanisë, vendim i datës 28.10.1999 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

¹⁰ Vendimet nr.9, datë 02.04.2003 dhe nr.11, datë 10.03.2003 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹¹ Çështja Ruiz Mateos kundër Spanjës, vendim i datës 23.06.1993 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.404, datë 30.11.2005 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.041/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Radiolink”, sh.p.k. për radion “Oxygen”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 17.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.424, datë 21.3.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS “DEUTSCHE WELLE”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.001/PPH, të rinovojë për një afat të ri 4-vjeçar për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritës subjektin “Deutsche Welle”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 14.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.425, datë 21.3.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV SOT 7”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas lincencës në nr.032/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “SOT 7” sh.p.k. për televizionin “TV SOT 7”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.427, datë 21.3.2006

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“PËRMETI”
SUBJEKTIT FIZIK: GJERGJI PETRO

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radio e televizivë analogjik tokësor, në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr.355 pika 1, datë 29.8.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.405, datë 20.12.2005 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë, radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik z.Gjergji Petro licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Përmetit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.428, datë 21.3.2006

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“TEPELENA SAT”
PERSONIT FIZIK: Z. DRITAN MEMUSHI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurën e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik, z.Dritan Memushi licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës për të penetruar në qytetin e Tepelenës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.429, datë 21.3.2006

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“BLU”
PERSONI FIZIK: Z. MENTOR GJUZI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me Vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve e me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik, z.Mentor Gjuzi licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në komunën Golem.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.430, datë 21.3.2006

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË RADIOS “FANTASY”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, neni 7 pika 21, neni 25 dhe 33, pika 1, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” dhe vendimi nr.404, datë 30.11.2005, të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit, ky i fundit

VENDOSI:

1. Në mbarim të fatit të licencimit, nuk rinovohet licenca për subjektin Radio “Fantasy”, pasi nuk ka shfaqur interes për rinovimin e saj.
2. Licenca me nr.039/FML bëhet e pa vlefshme.
3. Subjekti sipas pikës 1 të këtij vendimi ka të drejtën e ankimit në gjykatë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.241, datë 3.1.2006 vendosi të shpallë të zhdukur shtetasen Mirela Nasi, e bija e Gogos dhe e Agathisë, e datëlindjes 12.8.1975.

Abonimet vjetore mund te bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendres së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel. 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

U dorëzua për shtyp më 4.4.2006
Doli nga shtypi më 10.4.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë